



*Inicijativa za REKOM
Initiative for REKOM
Иницијатива за РЕКОМ
Nisma për KOMRA
Pobuda za REKOM*

Procesi KOMRA

Raport

Maj 2006 - gusht 2011.

Procesi i KOMRA-së ka filluar me inicimin e diskutimeve ndërmjet mekanizmave rajonale për verifikimin, identifikimin dhe komunikimin publik të fakteve për të kaluarën e afërt, e cila, pavarësisht nga gjykimi penal, mund të kontribuojë më tej në krijimin e një regjistrimi të plotë të së kaluarës. Vendimi për të iniciuar diskutimet rajonale është organizuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare të bëra në takimin e 10 organizatave udhëheqëse të drejtave të njeriut nga rajoni, në shtator të 2005 në Beograd. Përveç pjesëmarrësve nga vendet post-jugosllave, në takim morën pjesë edhe nga Qendra Ndërkombëtare Mark Freeman për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ). Pjesëmarrësit në takim mbështetën gjykimet e krimeve të luftës si një instrument më i rëndësishëm ligjor për përcaktimin e përgjegjësisë penale individuale për krimet e kryera por konkludoi se nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një regjistër historik të së kaluarës. Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH), Qendra për Hulumtime dhe Dokumentim (IDC), me seli në Sarajevë, dhe Dokumenta¹ me seli në Zagreb kanë marrë përsipër që në kuadër të shoqërisë civile në rajon ta nisnin iniciativën për debat mbi mekanizmat për përcaktimin dhe tregimin e së vërtetës për të kaluarën ku fokusi kryesor janë viktimat të cilat mundën përveç gjykimit penal të kontribuojnë në krijimin e një regjistri faktik të plotë për atë që ka ndodhur në të kaluarën.

1. Procesi konsultativ

Debati u hap në maj 2006, në Forumin e parë rajonal i organizuar nga FDH, IDC dhe Documenta mbi mekanizmat për përcaktimin e fakteve në të kaluarën. Deri në fund të qershorit 2011 janë mbajtur 127 konsultime, shtatë forume rajonale dhe një forum ndërkombëtar për drejtësi tranzicionale. Në konsultime kanë marrë pjesë 6187 aktivistë të organizatave për të drejtat e njeriut, organizatat e të rinjve, shoqatat e familjeve të viktimave, të burgosurve, veteranëve /ushtarëve, pastaj artistët, mësues, përfaqësues të kishave dhe bashkësive fetare dhe grupe të tjera si dhe shoqata të shoqërisë civile nga të

¹ Në përpjekje për të inkurajuar procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe krijimi një të vërtete faktike për luftën, Qendra për paqe, jo dhunë dhe të drejtat e njeriut-Osijek, Qendra për studimin e paqes, Këshilli i Helsinkit në Kroaci për Drejtat e Njeriut e themeluan Documenta në vitin 2004.

gjitha shtetet trashëgimtare të ish-Jugosllavisë. Procesi konsultativ u zhvillua në formën e debateve lokale, kombëtare dhe rajonale (konsultim publik) në grupe të vogla dhe diskutimet nëpër forume me nga 200 deri në 300 pjesëmarrës. Në forum morën pjesë përfaqësues të vendeve dhe organizatave ndërkombëtare. Mbështetjen profesionale iu ofruan dhe ekspertet e ICTJ.

Në qershor 2010 në procesin konsultativ u bashkëngjiten organizatat joqeveritare dhe shoqatat e viktimave dhe të veteranëve nga Maqedonia dhe pastaj organizatat joqeveritare dhe shoqatat të fshira nga Sllovenia.

Procesi konsultativ është planifikuar si një platformë publike për zërat e viktimave dhe grupet civile që kërkojnë një qëndrim të përgjegjshmërisë ndaj trashëgimisë së vështirë të së kaluarës; dhe bisedime aktive për të përfutur përkrahje nga opinioni i gjerë dhe qeverive për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e ish Jugosllavisë si dhe një rrugë e komunikimit për të përgatitur një propozim për statutin e KOMRA-s.

Procesi konsultativ kishte tri faza: së pari është diskutuar për nevojat dhe pritjet e viktimave në lidhje me trashëgiminë e vështirë të së kaluarës dhe mekanizmave jashtë gjyqësore për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës. Pastaj pjesëmarrësit, duke marrë parasysh përvojën e shoqërive të tjera post – konflikteve dhe shoqërive post-totalitare si dhe luftërave specifike në territorin e ish-Jugosllavisë i paraqiten sugjerimet, mendimet dhe rekomandimet mbi Komisionin Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës. Në fazën e tretë, nga maji 2010 pjesëmarrësit diskutuan për draft statutin e projektit KOMRA duke u bazuar në propozimet, mendimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve të procesit konsultativ dhe përzgjidhen e komisioneve të suksesshme, të bëra nga Grupi i Ekspertëve të KOMRA-së. Filluan konsultimet - sidomos me grupet e qytetareve të përfshirë në formësimin e modelit KOMRA, pastaj dhe me avokatët nga rajoni. Ka pasur debate të ashpra, frikësime për qëndrime të papajtueshme por puna e përbashkët tre-vjeçare e mundësoi për të arritur tek kompromisi për një dokument të përbashkët. Kuvendi i koalicionit për KOMRA me 26.03.2011 miratoi propozimin për statutin e KOMRA-së.

1.1. Konsultimet në lidhje me mekanizmat për përcaktimin dhe tregimin e së vërtetës për krimet e luftës në territorin e ish-Jugosllavisë

Nëntë konsultime (pesë rajonale dhe katër kombëtare) dhe tre forume rajonale për drejtësi tranzicionale të mbajtura në periudhën nga maji 2006 deri në maj 2008 ishin të përkushtuara në perceptimin e nevojave dhe pritjeve të viktimave dhe familjeve të viktimave në lidhje me shkeljet të rënda të të drejtave të njeriut në të kaluarën si dhe në shkëmbim të mendimeve se cilët mekanizma jo-gjyqësore janë më adekuat për shoqëri civile në territoret ku ka pasur luftëra dhe ku më shumë se 1 000 000 persona janë të zhvendosur.

Pjesëmarrësit të konsultimeve dhe forumeve plotësisht i mbështetën gjykimet lokale për krime lufte duke treguar se janë bërë më profesionale në sajë të krijimit të bashkëpunimit rajonal ndërmes

prokurorëve kombëtar². Një qasje rajonale duhet të zbatohet në përcaktimin e prezantimit publik të fakteve mbi krimet e luftës bazuar në përvojat e viktimave³ - pjesëmarrësit të këtyre konsultimeve dhe forumeve ishin dakord.

Në Forumin e tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale i mbajtur në Beograd me 11-12.02.2008, FDH, IDC dhe Documenta kanë dalë me një propozim për krijimin e një organi rajonal që do të merret me përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës, organi i cili është edhe nga pjesëmarrësit e debatit për mekanizmat e jashtë-gjyqësorit. Dëshmia publike e viktimave, e cila u organizua për herë të parë nga fillimi i procesit të konsultimit, pjesëmarrësit e kanë vlerësuar si aktivitet kryesor i këtij trupi punues regjional.

1.1.2. Mbështetje iniciativës për themelimin e KOMRA-së

Në konsultime me familjet e viktimave, veteranët dhe të burgosurit nga Kroacia, BdheH, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova, me 9.05.2008 në Mal të Zi, FDH, IDC dhe Documenta kanë dalë me iniciativë për themelimin e **Komisionit Rajonal për përcaktimin dhe tregimin publik të fakteve për krimet e luftës**, dhe u bëri thirrje pjesëmarrësve që të marrin pjesë aktivisht në formimin e modelit të këtij komisioni. Pjesëmarrësit propozuan themelimin e koalicionit rajonale i cili do të promovon nismën për themelimin e Komisionit Rajonal duke u përqendruar në përvojat e viktimave. Natasha Kandiç propozoi që komisioni rajonal të ketë shkurtesën KOMRA .

1.1.3. Themelimi i Këshillit Koordinues dhe Koalicionit për KOMRA

Ideatorët e iniciativës, FHP, Documenta dhe IDC kanë formuar⁴ Këshillin Koordinues me anëtarët të cilit janë përcaktuar në bazë të ftesës, ku detyra e parë ishte formimi i Koalicionit për themelimin e KOMRA-së dhe për t'ia bartë menaxhimin e procesit konsultativ. Deri më 28.10.2008, në Prishtinë është mbajtur Forumi i Katërt Rajonal për drejtësi tranzicionale ku dhe zyrtarisht është themeluar Koalicioni për KOMRA, rreth 100 OJQ dhe shoqata deri tani pjesëmarrëse të proceseve konsultative me shkrim e kanë informuar Këshillin Koordinues që dëshirojnë të jenë anëtarë/anëtar të KOMRA-së.

Në korrik të 2011, numri i anëtarëve të Koalicionit u rrit në 1818 ku prej tyre janë: 342 organizata joqeveritare, 64 shoqata të viktimave dhe anëtarëve e familjeve të viktimave, 12 shoqata të veteranëve, 25 media, 8 organizata fetare, 10 organizata të tilla si partitë politike, degët dhe komitetet e partive politike, organizata të pushtetit lokal, dhe 1357 persona nga radhët e viktimave, bashkësive fetare, artistë, shkrimtarë, regjisor dhe të tjerë. Koalicioni në BdeH numëron 369 anëtarë, në Mal të Zi 151 anëtarë, në Kroaci 174, në Kosovë 404, në Maqedoni 30, në Slloveni 22 dhe në Serbi 668 anëtarë.

² Mladen Bajčić, Prokurori i shtetit të Republikës së Kroacisë, *Procesi konsultativ për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish- Jugosllavisë*, qershor 2011, fq. 119

³ Esad Kočan, gazeta javore Monitor, Mali i zi, *Procesi konsultativ për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish- Jugosllavisë*, qershor 2011, fq.119

⁴ Këshilli koordinues është formuar me 9.05.2008 në Podgoricë, Mali i Zi.

Organi më i lartë i KOMRA-së është Parlamenti i cili mbahet në princip delegatesh, kryesisht për shkak të numrit të madh të anëtarëve. Deri në fund të korrikut 2011 Koalicioni për KOMRA ka mbajtur pesë seanca të anëtarëve të Kuvendit të Koalicionit. Në seancën e parë të Kuvendit të mbajtur në maj 2009 në Budvë, Kuvendi miratoi një statut që rregullon të drejtat dhe detyrimet e Parlamentit dhe anëtarëve të KOMRA-së.

Këshilli Koordinues ka për detyrë që të monitoron zbatimin e vendimeve të Kuvendit të KOMRA-së. Anëtarët e Këshillit Koordinues nuk paguhen për punën e tyre, përveç se dy anëtarë kanë të drejtë për të marrë mëditje për pjesëmarrjen e tyre në punën e KK-së pasi që janë të dytë papunë.

Sekretariati është një organ profesional i cili ka bashkëpunëtorë të cilët marrin kompensim për punën e tyre në përputhje me projektin për të cilin është përgjegjës Fondi për të Drejtën Humanitare. Anëtarët e Sekretariatit zbatojnë aktivitete të definuara në përputhje me projekt dhe të nga vendimet e Kuvendit të KOMRA-së.

1.2.Ndertimi i modelit të KOMRA-së

Në periudhën prej qershorit 2008 deri në qershor 2010 ka pasur diskutime intensivë rreth qëllimeve , detyrave dhe kompetencave dhe rolin e KOMRA-së në procedim penal, dëshmive publike dhe elementeve të tjera të Komisionit Rajonal. Ka pasur 77 konsultime⁵ dhe tre forume rajonale në të cilat morën pjesë 3509 përfaqësues të organizatave për të drejtat e njeriut, organizata të rinjve, bashkësive fetare, anëtarë të shoqatave të viktimave dhe familjeve të viktimave, veteran, artistë, historian dhe individë nga grupe tjera qytetare.

Gjatë debatit dy-vjeçar është qartësuar qëndrimi rreth detyrës primare që Komisioni Rajonal duhet ti përcaktojë faktet për të gjitha krimet e luftës ndërsa rreth shkaqeve të luftës mendimet kanë qenë të ndara. Të gjithë janë pajtuar se nuk ka detyrë më thelbësore se evidentimi individual i viktimave të krimeve të luftës, të rënëve dhe të zhdukurve dhe që KOMRA duhet të evidentojë të gjitha kampet e përqendrimit. Në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut, pjesëmarrësit u pajtuan pa përjashtim që KOMRA mund të kontribuoj më shumë se çdo mekanizëm tjetër për zgjidhjen e fatit e të zhdukurve dhe zbulimin e varrezave masive. Anëtarët e familjeve të personave të pagjetur kanë sugjeruar se KOMRA mund të propozojë gjykatave amnisti për autorët e krimeve të cilët do të ndihmonin në zbulimin e vendndodhjes së varrezave masive. Ky sugjerim u mbështet nga shumica e pjesëmarrësve ndërsa kishte dhe kundërshtime të mëdha. Një numër i pjesëmarrësve avokuan që KOMRA ka të drejtë për të thirrur ish-zyrtarët të autoritetit civil, përfaqësues të mediave, institucioneve dhe komuniteteve fetare për të folur për rolin dhe funksionimin e institucioneve çka dhe u pranua nga shumica ndërsa disa kanë sugjeruar se KOMRA duhet të drejtohet gjykatës për ndihmë në raste kur dëshmitari refuzon të paraqitet para komisionit.

⁵ Janë mbajtur 6 konsultime rajonale, 38 nacionale dhe 35 lokale në B dhe H, Kroaci, Mal të Zi, Serbi dhe Kosovë.

1.3. Diskutimi rreth draft statutit të KOMRA-së

Faza e tretë filloi në maj 2010 kur në konsultime me shoqata të viktimave në Tuzëll është paraqitur versioni i parë i Draft Statutit të KOMRA-ës. Për draft statutin është diskutuar në 22 konsultime dhe tre grupe punuese në Forumin e shtatë rajonal për Drejtësi Tranzicionale. Në kuadër të konsultimeve avokatët morën pjesë në tetë takime. Nga fillimi deri në fund të procesit të konsultimit ishin unanimitë në pikëpamjet e tyre në lidhje me kompetencat e komisionit.

Debati i madh ishte rreth dispozitave të draft statutit që KOMRA është duke e kryer kualifikimin ligjor për krime lufte nga gjenocidi deri tek dhunimet. Avokatët ishin unanimitë se kualifikimi ligjor është nën kompetencën e gjykatës. Nga ana tjetër, opinioni i ekspertëve të ICTY ishte që komisionet e së vërtetës duhen të jenë të pavarura dhe nga vendimet e gjykatave. Shembull ishte Komisioni Historik në Guatemalë i cili krimet në atë vend i kualifikoi ligjërisht si gjenocid çka ndikoi në ndarjen e mëtutjeshme të pjesëmarrësve. Përveç kësaj, disa pjesëmarrës mendonin se evidentimi i humbjeve njerëzore të ushtarëve dhe civilëve siç është paraqitur në draft statut mund të rrisë artificialisht numrin e ushtarëve të vrarë dhe kështu të ndikon në ndryshimin e natyrës së luftës. Dukej e pamundur për të arritur deri tek një qëndrim të përbashkët. Megjithatë, u tejkalua me një interes të përbashkët për t'i dhënë fund praktikës së Ballkanit, me viktima të paemëtuara dhe me kompromis tri ditë para kuvendit të Koalicionit për KOMRA arritën deri tek një dokument i përbashkët.

1.3.1. Miratimi i projekt-statutit të KOMRA-së

Koalicioni për KOMRA, në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur më 26.03.2011 miratoi projekt-statutin e KOMRA-së. Propozimi u përgatit nga një grup ekspertësh të koalicionit për KOMRA bazuar në propozimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve të procesit konsultativ dhe analizave të statutit të komisioneve të suksesshme e së vërtetës dhe të legjislacionit dhe komisionit parlamentar hetimor në vendet ish-Jugosllavisë. Grupi i ekspertëve përbëhej nga: politologu Vjeran Pavlaković (Kroaci), avokatët Tea Gorjanc Prelević (Mali i Zi), Mithat Izmirlija (BdheH) dhe Teki Bokshi (Kosovë), historiane Marijana Toma (Sërbia) nën mbështetjen e ekspertit, konsultant nga Qendra Ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale, Bogdan Ivanisević.

Draft statuti i KOMRA-së është përgatitur në gjuhën shqipe, boshnjake, malazeze, kroate, maqedonase, sllovene, serbe dhe angleze. Grupi ekspertësh të cilët e kanë përgatitur Draft Statutin e ka shkruar edhe "Shpjegime me Draft Statutin e KOMRA-së", në të gjitha gjuhët lokale.

1.4. Raporti i procesit konsultativ mbi nismën për themelimin e KOMRA-së

Procesi konsultativ nga Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale i mbajtur më 5-6.05.2006 në Sarajevë (BdheH) deri në konsultimet e fundit mbi draft statutin e KOMRA-së, në shkurt 2011 në tërësi është paraqitur në botimin *Procesi konsultativ për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë*. Publikimi përmban të gjitha propozimet, mendimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve të procesit konsultativ në

lidhje me mekanizmat jashtëgjyqësor për përcaktimin e fakteve, Nismën e themelimit të KOMRA-së si dhe për draft statutit të KOMRA-së. Botimi është publikuar në gjuhët BHS, shqip, maqedonisht, sllovenisht dhe anglisht. Janë shtypur në të gjitha gjuhët gjithsej 1320 kopje.

Përveç kësaj, të gjitha konsultimet dhe forumet janë të regjistruara, procesi konsultativ ka 127 video regjistrime dhe katër tregime dokumentarë.

2. Fushata mediale

Fushata mediale filloi në qershor të vitit 2010 për të informuar dhe për të përfituar opinionin publik rreth nismës KOMRA.

2.1. Fushata mediale si një promotor për nismën KOMRA

Faza e parë e një fushatë mediale me titull *Për KOMRA* filloi me 1 qershor 2010 në të njëjtën kohë në Sarajevë, Banja Llukë (BdheH), Beograd (Serbi), Podgoricë (Mal i Zi), Prishtinë (Kosovë) dhe Zagreb (Kroaci). Mesazhi i fushatës ishte *Faktet e të gjitha viktimave të luftërave 1991-2001 në territorin e ish-Jugosllavisë*.

Në kuadër të fushatës u transmetua një spot televiziv *Përse KOMRA* me pjesëmarrësit në spot duke folur në gjuhën e tyre amtare. Në periudhën prej 3.06.2010 deri 15.07.2010 spoti u transmetua mbi 1543 herë tek televizionet publike dhe private. Radio xhinglës *Përse KOMRA* është transmetuar 4 205 herë në radio të ndryshme në rajon.

Janë botuar nëntë reklama në shtyp. Në tetë gazeta lokale janë vendosur 90 000 nëntituj me shkrime *Të dimë, Për mua, Për të, Për ne*, më nga tre imazhe dhe slogane të ndryshme. Gjithsej janë botuar 540 000 fletushka.

Është hap web faqja www.zarekom.org, në të cilën që nga qershori 2010 është mundësuar qasja online në Koalicionin për KOMRA. Në më shumë se 20 portale është vendosur flamuri Nisma për KOMRA. Nga 15.07.2010 Nisma për KOMRA gjithashtu është në dispozicion përdoruesve të rrjetit Facebook dhe Twitter.

Në periudhën prej 1.11.2010 deri me 26.04.2011 Nisma për KOMRA ishte tema kryesore e 11 emisioneve televizive dhe një emisioni në radio.⁶

⁶ Në emision më të shikuar *Oko në RTS* (Serbi) me 3.12.2010 rreth draft statutit të KOMRA-së folën avokatët Tomislav Višnjic (Sërbi), Teki Bokshi (Kosovë) dhe një anëtar i KOMRA-së Amir Kulaglic (BiH).

Radio Evropa e Lirë transmetoi me 26.12.2010 në emisionin *Most*, në të cilin për Nismën KOMRA folën Dino Mustafic dhe Nataša Kandić, drejtoresha e FDH.

Në emision Club BHT i transmetuar (kohë e paguar) me 14.12.2010 në BHT (BdheH) për potencialin e nismës KOMRA në lidhje me pajtimin folën Dino Mustafic, regjisor dhe drejtor i MESS Festivali Teatrit Ndërkombëtar (BiH), Suad Kapić, regjisore dhe autore e projektit Rrethimi i Sarajevës, Srđan Puhalo, psikolog nga Banja Lluka dhe Velimir Njirić -Pšenićnik, aktori nga Mostari.

Festivali ndërkombëtar për skena të vogla dhe eksperimentale në Sarajevë (MESS) i cili u mbajt prej 16. deri me 31.10.2010 ishte plotësisht i dedikuar Nismës për KOMRA. Në kuadër të festivalit shfaqja *Gjenerata '91-95*. e teatrit të të rinjve nga Zagrebi e promovoi Nismën për KOMRA me 27.10.2010.

Shfaqja teatrale *Analogjia të Teatrit* familjet e përroit të qartë nga Serbia promovuan Nismën për KOMRA në Slloveni dhe Maqedoni (Lubjanë dhe Mariborë me 7, 8, dhe 9.02.2011, në Shkup me 31.03 dhe 1.04.2011).

2.2 Hulumtimi i opinionit publik për Iniciativën KOMRA

Në mënyrë që të përgatiten për fushatë të mbledhjes së nënshkrimeve si përkrahje të Nismës për KOMRA dhe duke iu falënderuar mbështetjes së Fondacionit OAK, agjencioni *Ipsos Strategic Pro në periudhën prej 17.02 deri me 20.03.2010* zhvilloi një anketë për opinion publik rreth Nismës për KOMRA në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Mali të Zi, Maqedoni dhe Kosovë.

Rezultatet e hulumtimit treguan se shumica e të anketuarve besojnë se duhet të ekziston një trup rajonal ndërqeveritar që do të merret me përcaktimin e fakteve të krimeve dhe viktimave të luftërave në ish-Jugosllavi. Peticioni për krijimin e një organi të tillë u nënshkrua nga shumica e qytetarëve të Kosovës (95 për qind), Mali të Zi (86 për qind), Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës (85 për qind) dhe Maqedonasit (75 për qind), ndërsa në Serbi peticioni është nënshkruar rreth 63 për qind nga qytetarët e Serbisë, në Republikën Srpska dhe Kroaci ndjeshëm, nën 50 për qind. Hulumtimet kanë treguar se Nisma për KOMRA është më pak e njohur në Kroaci dhe Republikën Srpska të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Në praktik u dëshmuar se Nisma për KOMRA fitoi përkrahje më të madhe në Kosovë, më së paku në Kroaci, ashtu siç hulumtimi dhe e parashikonte. Surpriza më e madhe është numri i madh i nënshkrimeve në Banja Llukë (Republika Srpska e Bosnjës dhe Hercegovinës) dhe mungesa e përkrahjes në Sarajevë (Federata).

2.3. Fushatë mediale si përkrahje fushatës për mbledhjen e nënshkrimeve

Në periudhën prej 26.04.2011 deri me 30.06.2011 mesazhi kryesor i fushatës mediale të KOMRA – së ishte- Nënshkruaj.

Së pari, agjencia *Ipsos Strategic Pro* në kuadër të fokus grupeve në prill 2011 zhvilloi një anketë të reagimeve të audiencës në lidhje me pesë spote televizive. Transmetimet filluan më 26 prill 2011, kur

Në emisionin *Balkan Express* (kohë e paguar) në TV ATLAS, transmetuar me 22.02.2011, folen për nismën KOMRA Dragoljub Vuković, gazetar shumëvjeçar dhe anëtarë i koalicionit për KOMRA dhe Eugen Jakovčić, koordinator i mediave për nismën KOMRA në Kroaci. Emisioni është ripërsëritur.

Në TV B92 Info (Serbi), në ciklin *Duart përplot më të kaluarën* janë emituar (kohë e paguar) tre emisione për nismën KOMRA në të cilin kane folur mysafirët Žarko Puhovski, profesor në Universitetin e Zagrebit (11.02.2011), Vesna Pešić, sociologe dhe deputete e Asamblesë Kombëtare të Republikës së Serbisë (11.03.2011) dhe Sonja Biserko, kryetare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi (12.04.2011).

filloi dhe fushata e mbledhjes së nënshkrime në të gjithë rajonin. Spotet ishin transmetuar në televizionet publike dhe private, gjithsej 1056 herë në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë.⁷

Për transmetim në radio janë bërë tetë xhingle. Janë emituar 1464 herë në radiot në Serbi, Bosnje, Mal Zi, Slloveni dhe Kroaci.⁸

Në tetë programe televizive (kohë e paguar) për Nismën KOMRA folën anëtarët të Koalicionit për KOMRA, figura të shquara publike të cilat mbështesin Nismën për KOMRA.⁹

⁷ Në Serbi, 492 shfaqje në RTS, TV Pink dhe TV Prva (Mesazhi dhe skeleti), në BdeH mbi 63 transmetime në BHT (Mesazhi, skeleti dhe kukulla), në Kroaci 92 transmetime në Kapital Network, HRT, TV Jadran dhe Osječka TV (skeleti), në Mal të Zi 60 transmetime në RTCG (kukulla), në Kosovë 205 transmetime në RTK, KTV, RTV21 dhe Klan Kosova (kukulla), në Maqedoni 124 transmetime në kanal 5, TV 24 dhe Alsat-M (Mesazhi, skeleti, kukulla), në Slloveni 20 transmetime në RTV Slovenia (mesazhi).

⁸ Në Serbi 143 transmetime në Radio S, Indeks dhe Roadstar; në BdeH 341 transmetim në Radio BH 1, Radio Sarajevo dhe Radio Kameleon; në Mal të Zi 961 transmetim në Radio Corona, Radio Ozon, Adriatik radio, Radio 083, Radio Jupok dhe Radio Skala; në Slloveni 15 transmetime në Radio Student; në Kroaci katër transmetime në Radio Vukovar, Radio Sljeme, Radio 101, Otvoreni Radio.

⁹ Në kuadër të ciklin *Duart përplot më të kaluarën*, në TV B92 Info (Serbi) janë emituar (kohë e paguar) edhe tre emisione ku folën për KOMRA Maja Mičić, drejtoresh e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (13.05.2011), Dragan Pevač, anëtarë i Shoqatës familjarëve të vrarë dhe të zhdukur Serbë në Kroaci *Suza*, (10.06.2011) dhe Nataša Kandić (26.06.2011).

Në emision Nisma për KOMRA të emituar (kohë e paguar) në TV Kapital Network (Kroaci) me 06.05.2011 dhe ripërsëritje me 13, 20 dhe 27.05.2011 ku morën pjesë: Vesna Teršelić (*Documenta*), Lazar Stojanović (drejtorë i fushatës mediale Nisma për KOMRA) dhe Željko Sabo (ish i burgosur dhe kryetar i Vukovarit).

Në Capital Network, me 6,13,20 dhe 27.05.2011 transmetohet dhe ritransmetohet emisioni Nisma për KOMRA (kohë e paguar) ku morën pjesë Vesna Teršelić (*Documenta*), Lazar Stojanović, drejtorë i fushatës mediale Nisma për KOMRA) dhe Željko Sabo (ish i burgosur dhe kryetar i Vukovarit).

TV Osijek (Kroaci) emitoi emisionin (kohë e paguar) Letrat në tavolinë të gazetares Gordana Flaudera me 18.05.2011 ku mysafire ishte Vesna Teršelić. Në emision janë emituar inserte në të cilët për Nismën KOMRA folën Katarina Kruhonja, anëtare e Këshillit koordinues të Koalicionit për KOMRA, Miren Špek, koordinator lokal i fushatës së mbledhjes së nënshkrimeve si dhe oponentëve të nismës dhe historianët Josip Jurčević i Ante Nazor..

Në NTV MONTENA, në emision SY në SY (kohë e paguar) i emituar me 10.05.2011 për nismën KOMRA folën Milan Antonijević (YUCOM, Serbia), Dijana Uljarević (Forum MNE, Mali i Zi), Mirela Rebronja (PR dhe koordinatore e Nismës për KOMRA në Mal të Zi). Emisioni u ritransmetua me 11 dhe 14.05.2011.

TV Jadran, televizioni lokal në Dalmaci e emitoi emisionin (kohë e paguar) Nisma për KOMRA me 22.05.2011. Para dhe pas emisionit u transmetua spoti Skelet.

Në emision *Evrozum* (themelimi i Koalicionit për KOMRA) të emituar në TV maqedonase TV 21 me 12.05.2011 rreth mbështetjes së nismës KOMRA ku folën Pierre Mirel, drejtor për Ballkan perëndimor në Drejtori të përgjithshme për zgjerim të Komisionit Evropian dhe Tanja Fajon deputete në Parlamentin Evropian, Nataša Kandić drejtoresh ekzekutive e FDH, Frosina Pandurska-Dramikjanin, PR i Nismës për KOMRA në Maqedoni dhe Gordana Duvnjak, anëtare Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA në Maqedoni. Emisioni u ritransmetua me 21.05.2011. Transkript i emisionit është botuar në gazetën të përditshme *Vreme* me 14.05.2011.

Materiali dokumentar (prodhimi i Koalicionit për KOMRA) në lidhje me miratimin e draft statutit të KOMRA-së me 26.03.2011 në kohëzgjatje prej 33 minuta është emituar në TV 24 maqedonase me 9.04.2011. Repriza është transmetuar me 10.04.2011. Autor i materialit dokumentar është gazetarja Marina Uzunov.

Fushata e KOMRA-së, *Nënshkruaj* është botuar në media të shkruara në Serbi¹⁰, Bosnjë¹¹ dhe Hercegovinë, Kroaci¹² dhe Slloveni¹³. Fushata KOMRA *Nënshkruaj* është hapur në web faqet e përdoruesve të Facebook për më tepër se 39 320 767 herë, e vizituan (klikim) 24 491 përdorues nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Kroacia, Maqedonia dhe Serbia. Mesazhe Promo mesazhe me përmbajtje të njëjtë janë dërguar në 428 121 adresë të përdoruesve të bazës së dhënave në sajtin Neogen.rs., 6908 përdorues e kane lexuar mesazhin dhe janë informuar për Iniciativën KOMRA .

Në web faqet më të rëndësishme në rajon, janë vendosur 12 banera të reja me mesazh KOMRA - Nënshkruaj¹⁴. Në faqet e më shumë se 250 organizatave të cilat merren me ballafaqimin e të kaluarës dhe krimet e luftës janë vendosur linçe në drejtim të faqes Nisma për KOMRA, www.zarekom.org.

Menjëherë pas nisjes së fushatës e mbledhjes së nënshkrimeve me 27.04.2011, faqja Nisma për KOMRA në Facebook është vizituar nga 35.565 përdorues. Prej datës 10.07.2011 deri me 31.08.2011 këtë faqe e kanë 1720 përdorues, mesatarisht 34 përdorues të ri në ditë. Gjatë kësaj periudhe, janë vendosur 3343 përmbajtje që përdoruesit kanë klikuar rreth 1 314 223 herë. Faqet shitesë të dedikuara KOMRA –së të cilat përdoruesit bëjnë në iniciativën e tyre e vizitojnë r një numër i madh të përdoruesve (Serbia për KOMRA - mbi 2 000, Kroaci për KOMRA - mbi 1 300, etj).

Në fund të marsit 2011 është vendosur faqja e ridizajnuar www.zarekom.org. Bazuar në statistikat e Google Analytics vizita në web faqe ka ra për 1.48 për qind. Nga gjithsej 52 111 vizitorë kanë vizituar faqen prej datës 01.06.2010 deri me 31.08.2011 duke klikuar 233 668 herë. Mesatarja ditore që kanë vizituar web faqën është 114,03 përdorues në ditë.

Në Forum www.zarekom.org përmbyllur me datën 20.06.2011 janë regjistruar 93 223 përdorues. Në ditë janë regjistruar 405,33 përdorues të rinj. Me datën 20.06.2011 janë vendosur 177 tema dhe 100 përmbajtje. Gjatë periudhës raportuese në më shumë se 350 forume me përmbajtje të ngjashëm të Forumit www.zarekom.org është vendosur lidhja e linkut.

Janë mbajtur katër koncerte të cilët e promovuan Nismën për KOMRA, në Lubjanë (26.05.2011), në Shkup (30.05.2011), në Mal të Zi (1.06.2011) dhe në Bosnje dhe Hercegovinë (28.05.2011). Koncertin në Shkup u shoqërua nga mbi 1.000 njerëz dhe janë mbledhur 750 nënshkrime për themelimin e KOMRA-së. Koncerti i mbajtur nga pop-rock grupa me e famshme e Malit të Zi, *Perper* për KOMRA është dëgjuar nga më shumë se 600 njerëz.

¹⁰ Politika, Danas, Blic, Dnevnik, Magyar Szo, Nin, Vreme.

¹¹ Oslobođenje, Dnevni list, BH Dani, Slobodna Bosna.

¹² Novosti, Novi list, 24 sata.

¹³ Mladina.

¹⁴ Ndër të tjera në portale serbe: www.rts.rs, www.pressonline.rs, www.e-novine.com, www.blic.rs; të Bosnjës dhe Hercegovinës: www.sarajevo-x.com, www.depo.ba, www.zurnal.ba; kroate: www.index.hr, www.net.hr; malazeze: www.pcnen.com i www.monitor.co.me; kosovare: www.telegrafi.com i www.koha.net; maqedonase: www.alsat-m.tv; sllovene: www.mladina.si.

Pas shfaqjes së *Gjenerata 91-95*. ne teatrin rinor ne Zagreb me 13.05.2011 është mbajtur një diskutim *Arti dhe ballafaqimi me të kaluarën*. i moderuar nga Gordan Bosanac, CMS, në diskutim morën pjesë: Nadežda Čačinović, filozofe, Borut Šeparović, regjisor, Dubravka Vrgoč, drejtoresh e ZKM-së dhe Vesna Teršelič. Dhe në universitete në rajon janë mbajtur disa takime, të dedikuara kryesisht për të rinjtë dhe marrëdhëniet e tyre me trashëgiminë e së kaluarës ku pjesëmarrësit janë informuar për Nismën KOMRA¹⁵.

Shfaqja *Analogjie* e ka promovuar KOMRA-në me 27 dhe 28 05 2011 në festivalin *Mixer* në Beograd.

Në shtyp rajonal dhe ndërkombëtar janë botuar 11 tekste autoriale rreth Nismës për KOMRA.¹⁶

Për fushatën e mbledhjes së nënshkrimeve dhe avokim publik është përgatitur materiali i shtypur në të gjitha gjuhët lokale si dhe në gjuhën angleze: fletëpalosje informative (390 800), Propozim Statuti i KOMRA-së - Shkurt (390 800), Draft Statuti i KOMRA-ës (4 200), Sqarime lidhur me Propozim Statutin e

¹⁵ *Da se zna, da se ne ponovi*, Fakultet političkih znanosti Zagreb, Hrvatska. Sudionici: Žarko Puhovski, Vesna Teršelič, Ivan Novosel (06.04.2011.)

Da se zna, da se ne ponovi, Pravni fakultet Osijek, Hrvatska. Sudionici: Katarina Kruhonja, Ivan Novosel, Eugen Jakovčić. (19.04.2011.)

Prema obnavljajućoj pravdi i pomirenju, savjetovanje Pax Christija za Srednju i Jugoistočnu Europu, Vukovar, Hrvatska Sudinici: Vesna Teršelič, fra Mijo Džolan, biskup Kewin Dowling (28.04.2011.)

Da se zna, da se ne ponovi, Filozofski fakultet Beograd, Srbija. Učesnici: prof. dr Bora Kuzmanović, dr Jovo Bakić, dr Nebojša Petrović (28.03. 2011)

Da se zna, da se ne ponovi, Filozofski fakultet Novi Sad, Srbija. Učesnici: dr Žolt Lazar, Aleksandra Jerkov, Maja Mičić, Jovana Kolarić (01.04.2011)

Da se zna, da se ne ponovi, Pravni fakultete Niš, Srbija. Učesnici: Draško Bjelica, Nebojša Ranđelović, Zorica Miladinović, Dušan Lopušina (11.04. 2011)

Suočavanje s prošlošću-Inicijativa REKOM, Akademija za politički razvoj, Donja Stubica, Hrvatska, (14.05.2011.) Uvodno izlaganje Eugen Jakovčić.

Zašto REKOM-kako smo se do sada nosili s kršenjima ljudskih prava u regimi, Pula, Hrvatska. Sudionici: Žarko Puhovski, Eugen Jakovčić, Goran Božičević (24.05.2011.)

Da li znate šta je REKOM? Tribina u okviru festivala *Vivisect*. Novi Sad, Vojvodina, Srbija. Govorili su: Marija Gajicki, direktorka festivala, Željko Stanić, koordinator kampanje prikupljanja potpisa u Vojvodini, Tijana Savkov PR Inicijative za REKOM u Srbiji (15. 05.2011.)

Zašto REKOM, Pravni fakultet Univerziteta *Union* Beograd, Srbija Učesnici: prof. dr Vladimir Vodinelić, prof. dr Violeta Beširević i Maja Mičić. (18. 05. 2011.)

Zašto je važno potpisati za REKOM? Tribina u okviru Sajma organizacija civilnog društva, Beograd, Srbija. Govorili su profesor Pravog fakulteta Zoran Ilić, Ivana Stjelja iz Udruženja Pravnici za demokratiju, predsednik NUNS-a Vukašin Obradović, i Dušan Lopušina iz Inicijative mladih za ljudska prava u Srbiji. (3. 06. 2011.)

¹⁶ *Danas* (Srbija), *Da mrtvi ne utihnu podržimo REKOM*, Lazar Stojanović (19. 05. 2011.)

Jutarnji list (Hrvatska), *Zašto sam podržao REKOM*, Miljenko Jergović (31. 05.2011.)

The New York Times, *The Shame of Serbia*, Nataša Kandić, June 5, 2011

Slobodna Evropa, *Kandić: Regionu je potrebno suočavanje sa prošlošću* (7. 06.2011.)

Dani (BiH), *Da nema Haškog tribunala, trebalo bi ga izmisliti*, Dženana Karup Druško (1.07.2011)

Večernji list (Hrvatska), *Cilje REKOM-a – ne utvrditi konkretnog agresora*, Tihomir Dujmović (9.07.2011).

Blic.rs (Srbija), *Bez argumenata protiv REKOM-a*, Goran Miletić (12.07.2011)

Peščanik (Srbija), *Starh od malih brojeva* (12.07.2011)

Dani (BiH), *Borba za istinu*, Dženana Karup Druško (15.07.2011)

Peščanik (Srbija), *Papazjanija*, Goran Miletić (20.07.2011)

Danas (Srbija), *Zalogaj koji lokalno zastaje u grlu*, Svetlana Slapšak (23.07.2011)¹⁶

KOMRA-ës (330), formular për nënshkrime dhe materiale të ndryshme promovuese (stema, bluza, shalle, bexha etj).

3. Fushata për mbledhjen e 1.000 000 nënshkrime për KOMRA-në¹⁷

Fushata 1 000 000 nënshkrime për KOMRA-në u hap me 26.04.2011 me aksionin Shkrija Rajonale e cila u mbajt në të njëjtën kohë në Beograd, Lubjanë, Zagreb, Sarajevë, Banja Llukë, Prishtinë, Shkup. Fushata zgjati deri më 30 qershor 2011 ku për nëntë javë janë mbledhur 543 870 nënshkrime si përkrahje për themelimin e KOMRA-së. Në Bosnjë dhe Hercegovinë janë mbledhur 122 540 nënshkrime, në Kroaci 19 674 nënshkrime, në Mal të Zi 31 060, në Serbi 254 625, në Kosovë 100 566, në Slloveni 5 346 dhe Maqedoni - 10 059 nënshkrime.

Koordinatori rajonal të fushatës së mbledhjes së nënshkrimeve ishte Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci. Fushata përfshiu 1301 vullnetarë, aktivistë, organizata të rinjve dhe anëtarë të rinj të disa partive politike. Ata mbledhën nënshkrimet nëpër 219 pika në kryeqytete dhe qytete të mëdha si dhe me aksion nga derë në derë.

E papritur për fushatën ishte një numër i madh i nënshkrimeve të mbledhura në Banja Llukë (46 000) dhe Kosovë (100 566), pavarësisht nga mungesa e mbështetjes politike dhe mediave dhe thirrjes në bojkot nga kryetarët të shoqatave të viktimave dhe të veteranëve. Mbështetja e ulët të qytetarëve në Kroaci është pjesërisht pasojë e rezistencës së gjerë për bashkëpunim rajonal i cili është më tej e theksuar për shkak të vendimit të prerë ndaj gjeneralëve Ante Gotovina dhe Mladen Markač të shqiptuara nga Tribunali i Hagës me 15.04.2011.

Mbledhja e 1 000 000 nënshkrime të planifikuara nuk e realizua dhe kritikët e Nismës për KOMRA e vlerësuan si dështim i procesit të projektit KOMRA. Duke pasur parasysh se Koalicioni për KOMRA ka arritur të sigurojë një pjesë të vogël të fondeve të nevojshme për zhvillimin e fushatave e planifikuar me 2 500 vullnetarë dhe 600 pikë në rajon dhe rezistencën publike në Kroaci, objektivisht 543 870 nënshkrime të mbledhura paraqesin përkrahje të madhe Nismës për KOMRA. As para dhe as pas luftës, në territorin e ish-Jugosllavisë, nuk është nisur asnjë iniciativë e vetme rajonale që ka pasur përkrahje më të madhe. Nisma për KOMRA është bërë initiative e rëndësishme qytetare, e cila ka potencial për t'iu përgjigjur nevojave sociale për një rivlerësim kritik të përbashkët ndaj trashëgimisë së vështirë të së kaluarës.

4. Avokim publik për themelimin e KOMRA-së¹⁸

Nisma për themelimin e KOMRA-së mori përkrahje deklarative të përfaqësuesve më të lartë të qeverisë dhe elitës politike të vendeve të Jugosllavisë së dikurshme.

¹⁷ Më shumë fushata për mbledhjen e nënshkrimeve në raport të Nismës e të rinjve për fushatë 1 000 000 nënshkrime për KOMRA-në, www.zarekom.org

¹⁸ Më shumë rreth avokimit publik në Raport për avokim publik, të cilin e përgatiti Sekretariati i Koalicionit për KOMRA, www.zarekom.org.

Në **BdheH** e përkrahën themelimin e KOMRA-së Željko Komšić, anëtar i kryesisë së BdheH, Živko Budimir dhe Svetozar Pudarić, kryetari dhe nënkryetari i Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës, Sulejman Tihić, kryetar i Partisë për Veprim Demokratik (SDA), një numër i ministrave, anëtarëve të Partisë Social Demokratike (SDP) pastaj partitë politike të HDZ 1990, Partia popullore *Me punë në progres*, Partia jonë si dhe një numër i madh i politikanëve lokalë.

Në **Kroaci** KOMRA është përkrah nga Kryetari i Republikës së Kroacisë Ivo Josipović, nën kryetari i Qeverisë së Republikës së Kroacisë Slobodan Uzelac, Partia Demokratike e Pavarur Serbe, disa anëtarë të Parlamentit kroat nga Kuvendi i Istres Demokratike dhe nga Partia Social Demokratike e Kroacisë. Željko Sabo kryebashkiaku i Vukovarit dhe anëtar i SDP ofroi përkrahjen për themelimin e KOMRA-së. Partia Social Demokratike e Kroacisë nuk e përkrahi themelimin e KOMRA-së. Qëndrimi i SDP të Kroacisë ishte se për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës është detyrë e shtetit e jo e një trupit rajonal.

Në **Serbi** themelim e KOMRA-së e përkrahi presidenti i Serbisë Boris Tadić, presidentja dhe kryetarja e Kuvendit popullor të Republikës së Serbisë Slavica Đukić Dejanović, Kryetar i Qeveris së Vojvodinës, Bojan Pajtić dhe kryetari i Kuvendi të Vojvodinës Šandor Egereši, Partia Demokratike, G17 + / Rajonet e Bashkuara të Serbisë, Lëvizja e veteranëve, Lëvizja serbe e rindërtimit, Lidhja e Social Demokratëve të Vojvodinës, Partia Liberale Demokratike dhe Partia për Veprim Demokratik.

Në **Mal të Zi** KOMRA është përkrahur nga kryetari i Malit të Zi Filip Vujanović, kryeministri i Malit të Zi Igor Luksić, dhe nga klubet parlamentare të Partisë social demokratike, Partisë boshnjake, Partisë popullore socialiste, Demokracisë së re serbe , Partisë Demokratike Socialiste si dhe partitë shqiptare.

Në **Kosovë**, KOMRA është përkrahur nga kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës Isa Mustafa, Ministri i Shëndetësisë së Kosovës Ferid Agani, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe njëra nga përfaqësuesit e serbëve në Kosovë si dhe bartëse e Listës unike serbe në parlamentin e Kosovës Rada Trajković.

Në **Maqedoni** KOMRA është përkrahur nga disa deputetët e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë , Zymreta Jakupi (Unioni Demokratik për Integrim), Stojan Andov (Partia Liberale), nënkryetar i Partisë Liberale, John Veličkovski, anëtar i Komisionit Ekzekutiv të Lidhjes Social Demokratike të Maqedonisë Taleski Dane dhe nga Partia Dinjiteti.

Në **Sllloveni** Nismën për KOMRA e kanë përkrah kryetari i Republikës së Slllovenisë Danilo Türk, kryetari i Parlamentit të Slllovenisë Pavel Gantar si disa deputetët e Kuvendit shtetëror, anëtarë të Parlamentit qeveritar nga Demokracia Liberale e Slllovenisë dhe Partisë slllovene Demokratike nga avokati i popullit Zdenka Čebašek Travnik dhe deputetet në Parlamentit Evropian Jelko Kacin dhe Tanja Fajon.

4.1. Përkrahje ndërkombëtare

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut ne Parlamentin Evropian, në takimin e mbajtur me 30.09.2010 ofroi përkrahje të plotë Nismës për KOMRA. Drejtori i delegacionit për marrëdhënie me Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbin, Malin e Zi dhe Kosovën Eduard Kukan ka ftuar Parlamentin Evropian dhe Komisionin Evropian për një përkrahje afat-gjatë të "Nismës unike." Me këtë rast, drejtori për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për zgjerim në Komisionin Evropian, Pierre Mirel tha: "KOMRA është një shtesë e nevojshme për procesin gjyqësor dhe për atë ne duhet të fitojmë përkrahje

e të plotë të qeverive dhe parlamenteve." Kryetarja e nën-komitetit për të drejtat e njeriut në Parlamentit Evropian, zonja Heidi Hautula ka vlerësuar se "kjo është hera e parë që një iniciativë e rëndësishme si kjo, vjen nga poshtë."

Përkrahja nga Parlamenti Evropian u ofrua në takimin e katërt interparlamentar të Kuvendit Kombëtar të Serbisë dhe Parlamentit Evropian të mbajtur me 05.10.2010 në Beograd me ç' rast mbështetjen e Nismës për KOMRA e ofruan kryetari i Komitetit për Integrim Evropian të Parlamentit të Serbisë Laslo Varga dhe kryetari i delegacionit të Parlamentit Evropian në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi dhe Kosovës, Eduard Kukan.

Parlamenti Evropian në rezolutën e miratuar me 19.01.2011 e përkrahi Nismën KOMRA si proces i ngritjes së vetëdijes dhe pajtimit në Ballkanin Perëndimor dhe ka ftuar pushtetin e Serbisë, dhe vendeve të tjera të ofrojnë përkrahje për këtë iniciativë.

Asambleja Parlamentare, me 26.01. 2011, ka miratuar raportin e raportuesit Komitetit për punë të jashtme

të Këshillit të Evropës, z. Pietro Marcenaro, i cili ka ftuar "të gjitha vendet në rajonin e ish Jugosllavisë të marrin pjesë në themelimin e KOMRA, pavarësisht nga statusi i tyre, në mënyrë që ai Komision të realizojë funksionin e pajtimit të plotë dhe pranimit të viktimave". Asambleja parlamentare ka miratuar Rezolutën 1786 (2011), me të cilën, posaçërisht, është theksuar mbështetja ndaj nismës për formimin e Komisionit rajonal për vendosjen e fakteve mbi krimet e luftës në territorin e ish RSFJ-së (KOMRA), i cili ka për qëllim që të shpreh respekt dhe t'i pranojë të gjitha viktimat.

5. Procesi i institucionalizimit të KOMRA-së

Nisma për KOMRA së pari kaloi në duart e pushtetit të Malit të Zi. Gjatë muajit qershor 2011 Qeveria e Malit të Zi formoi një grup punues për të shqyrtuar Nismën për KOMRA. Në muajin qershor 2011 në Kroaci, Koalicioni për KOMRA ia dorëzoi Nismën për themelimin e KOMRA-së, Propozim Statutin e KOMRA-së dhe petitionin për themelimin e KOMRA-së, kryetarit të Republikës së Kroacisë Ivo Josipović dhe anëtarit të Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Željko Komsić Të dytë kanë shpreh përkrahje të fortë personale duke u obliguar që në vendet e tyre dhe brenda aktiviteteve rajonale do të promovojnë nismën për themelimin e KOMRA-së.

Koalicionit për KOMRA i vijojnë takimet me presidentët e vendeve të tjera në rajon, pastaj, ti përfiton institucionet përkatëse për të iniciuar procedurën e lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare apo lidhjes së marrëveshjes politike për themelimin e KOMRA-së.